

VENDIM
Nr. 379, datë 11.6.2014

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1, DATË 10.1.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

Në “Rregullat e prokurimit publik”, që i bashkëlidhen vendimit nr. 1, datë 10.1.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në pikën 3 të kreut III, “Dokumentet e tenderit”, të bëhen këto shtesa:

1. Në nënndarjen “i”, “Për kapacitetet financiare dhe ekonomike”, të shkronjës “a”, “Kontratat e punëve”, pas fjalëve “...një deklaratë për gjendjen financiare nga një ose më shumë banka...” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”

2. Në nënndarjen “i”, “Për kapacitetet financiare dhe ekonomike”, të shkronjës “b”, “Kontratat e mallrave”, pas fjalëve “...një deklaratë për gjendjen financiare nga një ose më shumë banka...” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”

3. Në nënndarjen “i”, “Për kapacitetet financiare dhe ekonomike”, të shkronjës “c”, “Kontratat e shërbimeve”, pas fjalëve “...një deklaratë për gjendjen financiare nga një ose më shumë banka...” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama